



Prishtinë, 12 nëntor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1310_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrithshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrave Nr. 1699/18 ZK Laplja Selo, me kapacitet të instaluar prej 80 kW në Komunën e Graçanicës, e pranuar me datës 30.10.2020 nr. prot. 645/20 nga aplikuesi "SOLID GROUP" SH.P.K., me adresë: Magji. "Prishtinë - Ferizaj", Komuna e Graçanicë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 12 nëntor 2020 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "SOLID GROUP" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastrave Nr. 1699/18 ZK K Laplja Selo, me kapacitet të instaluar prej 80 kW në Komunën e Graçanicës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi "SOLID GROUP" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE-9036765 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE** do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi "SOLID GROUP" SH.P.K.**, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.




Arsyetim

- ZRRE, me datë 30.10.2020 nga aplikuesi "SOLID GROUP" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 1699/18 ZK Laplja Selo, me kapacitet të instaluar prej 80 kW në Komunën e Graçanicës.
 - Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik Nr. 8495 të datës 26.10.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. II. 772/20 i dt. 20.10.2020 të lëshuar nga Departamenti për Planifikim, Urbanizmit dhe Mbrojtjen e Mjedisit e Komunës së Graçanicës.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "SOLID GROUP" SH.P.K., dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 1699/18 ZK Laplja Selo, me kapacitet të instaluar prej 80 kW në Komunën e Graçanicës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:



Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar



Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Graçanicës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.